Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
03 -07- 2013
Prishtinë / Pristina
Nr. / Br. 619-2013

Në bazë të nenit 15, 23 dhe 64.2 (a) dhe (b), 128 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 13, 20 dhe 29 të Ligjit nr. 03/072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 02.07.2013, nxjerr:

RREGULLËN Nr. 01/2013
PËR REGJISTRIMIN DHE VEPRIMIN E PARTIVE POLITIKE

Neni 1
Dispozitat e përgjithshme

Kjo rregull ka për qëllim të rregullojë procedurat për: regjistrimin e partive politike, refuzimin e kërkesës për regjistrim, pezullimin, ankesat, bashkimin dhe shkrirjen e partive politike, përmbajtjen e statutit të partisë, kuvendet dhe çregjistrimin partive politike.

Neni 2
Përkufizimet

2.1 **Borxhi** - do të thotë të gjitha shumat monetare të cilat subjekti politik është i detyruar t'ua paguaj personave të tjerë.

2.2 **KQZ-ja** - do të thotë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organ i pavarur i ekspertëve përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve.

2.3 **Kuvendi i partisë** - do të thotë mbledhje e përgjithshme e të gjithë anëtarëve të partisë politike ose delegatëve të zgjedhur në mënyrë demokratike nga të gjithë anëtarët.

2.4 **Pagesa** - do të thotë transferimi i pagesës në vlerë, përfshirë edhe pagesën në formë të mallrave dhe shërbimeve. Pagesa bëhet në kohën kur merret përfitimi nga paguesi.

2.5 **Parti politike** - do të thotë një organizim i individëve të cilët janë bashkuar vullnetarisht mbi bazën e ideve, interesit dhe pikëpamjeve të përbashkëta, me qëllim të

ushtrimit të ndikimit dhe pasjes së përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në zyrë publike, ose siç është e përcaktuar ndryshe me legjislacionin në fuqi.

2.6 **Pasuria** - do të thotë e tërë pasuria e paluajtshme ose e luajtshme në pronë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, përfshirë parat e gatshme në dorë ose depozitat bankare, si dhe të ardhurat që burojnë prej tyre nga shitja, kalimi në posedim të një personi të tretë apo marrëveshje tjetër, vlera e bizneseve në pronësi dhe çdo send në zotërim që ka vlerë më të madhe se pesëqind euro (500) dhe me jetëgjatësi ekonomike më të gjatë se tre (3) vjet.

2.7 **Personi kontaktues** - do të thotë personi i cili është i autorizuar të komunikojë në emër të partisë politike me Zyrën.

2.8 **Përfaqësuesi financiar** - do të thotë personi që është personalisht përgjegjës për mbajtjen e shënimeve financiare të subjektit politik, duke siguruar pajtueshmërinë e subjektit me këtë ligj dhe duke komunikuar me Sekretariatin e KQZ-së lidhur me raportet për deklarimin e financave të fushatës së subjektit.

2.9 **Subjekt politik** - do të thotë parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur;

2.10 **Zyrë** - do të thotë Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim që vepron në kuadër të KQZ-së, ashtu siç është e saktësuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 3
Regjistrimi i partive politike

3.1 Partia politike mund të paraqitet për regjistrim duke ia dorëzuar zyrës:

3.1.1 aplikacionin e plotësuar në formën siç është përshkruar në shtojcën (1) që përfshinë me sa vijon:

a) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të kryetarit të partisë;

b) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të autorizuar financiar të partisë;

c) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit të autorizuar për të komunikuar në emër të partisë me KQZ-në;

d) numrin e telefonit dhe adresën postare të zyrës qendrore të partisë;

e) deklaratën e nënshkruar nga kryetari i partisë për të respektuar dhe për t'iu përmbajtur Kodit të Mirësjelljes së Partive Politike;

3.1.2 statutin e partisë në përputhshmëri me nenin 14 të kësaj rregulle,

3.1.3 çfarëdo shkurtese apo shenje të partisë;

3.1.4 deklaratën e fundit financiare të partisë, që përshinë me sa vijon:

a) dëshmia bankare për pagesën për regjistrim;
b) të dhënat e donatorëve;
c) kontratën për shfrytëzim të lokacionit për zyrë apo dëshmi bankare për pagesa të qerasë;
d) dëshmi tjera financiare për mjetet dhe pajisjet e pranuara nga koha e themelimit te iniciativës;

3.1.5 datën e konventës më të fundit të partisë; shtojca (2),

3.1.6 deklaratën e përkatësisë etnike të themeluesit të iniciativës politike,

3.1.7 emrin dhe adresën e së paku 500 anëtarëve të partisë të cilët banojnë në Kosovë dhe të cilët gjenden në Listën e Votuesve të Kosovës; shtojca (3) që përshinë me sa vijon:

a) emrin dhe mbiemrin;
b) datën e lindjes;
c) adresën;
d) numrin i telefonit;
e) numrin personal;
f) nënshkrimin;

3.1.8 programin politik të partisë që është paraqitur për regjistrim, të miratuar nga organi i saj më i lartë, ku paraqiten objektivat politike dhe aktivitet e partisë, të cilat duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën e Republikës se Kosovës dhe ligjet në fuqi.

3.1.9 taksën e pakthyeshme për regjistrim prej 500 (pesëqind) euro.

Neni 4
Shqyrtimi i kërkesave

4.1 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i aplikimit, Zyra e njofton KQZ-në për statusin e aplikimit, duke rekomanduar regjistrimin, duke rekomanduar mos regjistrimin, ose duke saktësuar fusha të tjera që mund të kërkojnë sqarime shtesë.

4.2 Zyra i shqyrton kërkesat brenda dhjetë (10) ditëve nga pranimi i tyre

4.3 Nëse kërkesa është pakompletuar apo nëse nevojiten të dhënat shtesë për shqyrtim e kërkesës, Zyra do të kërkoj nga kërkuesi që të siguroj të dhënat shtesë brenda pesë (5) ditëve nga marrja e kërkesës nga Zyra.

4.4 Nëse Zyra e pranon si të kompletuar kërkesën e partisë politike që është paraqitur për regjistrim, e shpallë atë në gjuhët zyrtare në Kosovë, në një apo më shumë gazeta me tirazh më të madh, si dhe në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, brenda shtatë (7) ditëve.

4.5 Secili mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 5 të kësaj rregulle, me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë, së bashku me çfarëdo të dhëne apo materiali që mbështetë kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e kërkesës nga neni paraprak 4.4 i kësaj rregulle.

4.6 Nëse nuk ka kundërshtime nga neni 4.5 dhe Zyra konstaton se nuk ka arsye për refuzimin e regjistrimit nga neni 5 i kësaj rregulle, Zyra brenda tre (3) ditëve i rekomandon KQZ-së për regjistrimin e partisë politike dhe për këtë e njofton partinë.

4.7 Nëse ka kundërshtime sipas nenit 4.5 të kësaj rregulle, Zyra e njofton iniciativën politike lidhur me kundërshtimin në afat prej 24 orëve nga pranimi i kundërshtimit dhe kërkon sqarime shtesë nga iniciativa politike në afat prej 24 orëve. Zyra e shqyrton kundërshtimin dhe sqarimet shtesë brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kundërshtimit dhe i rekomandon KQZ-së miratimin apo refuzimin e kërkesës për regjistrim. Nëse KQZ-ja e miraton kërkesën për regjistrimin e partisë politike, i njofton partinë dhe palët që kanë paraqitur kundërshtim për vendimin përmes ZRPP-së.

4.8 Pas vendimit të KQZ-së, Zyra menjëherë e njofton partinë politike të paraqitur për regjistrim dhe palët që kanë paraqitur për kundërshtim, lidhur me refuzimin e kërkesës së saj dhe konstaton se ekzistojnë një apo më shumë arsye për refuzim nga neni 5 i kësaj rregulle.

4.9 Njoftimi për refuzimin e kërkesës për regjistrim që i dërgohet partisë politike të paraqitur për regjistrim, përfshin arsyet me shkrim për refuzimin dhe informon

kërkuesin për të drejtën e tij që të ankohet sipas nenit 9 të kësaj rregulle.

4.10 Partia politike që përfshihet në regjistrin e partive politike fiton statusin e personit juridik me zotësi për të pasur pasuri, për të lidhur kontrata, për të paditur dhe për tu paditur në emër të saj

Neni 5

Arsyet për refuzimin e regjistrimit

5.1 KQZ-ja e refuzon kërkesën e partisë politike për regjistrim, nëse:

a) dokumentet e regjistrimit, duke përfshirë edhe statutin e partisë, nuk i plotësojnë kërkesat e kësaj rregulle ose janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi;

b) partia shkel nenin 18.2 dhe 18.3 të kësaj rregulle;

c) partia paraqitet për regjistrim me emër, akronim ose simbol që sipas vlerësimit të Zyrës, mund të nxisë urrejtje apo dhunë ndëretnike apo religjioze;

d) partia paraqitet për regjistrim me emër, akronim ose simbol që është i njëjtë dhe sipas vlerësimit të Zyrës, tepër i ngjashëm me emrin, akronimin ose simbolin e partisë të regjistruar më herët nga KQZ-ja. Nëse dy parti paraqiten për regjistrim me emër, akronim apo me simbole të njëjta a shumë të ngjashme, Zyra vendos se cila prej tyre ka të drejtë të regjistrohet me emrin apo simbolin e saj, duke marrë parasysh rrethanat e përgjithshme, si:

(i) datën kur secila parti e ka dorëzuar kërkesën;
(ii) datën kur secila parti e ka përdorur se pari emrin ose simbolin e saj.

Neni 6

Pezullimi i partive të regjistruara politike

6.1 KQZ-ja e pezullon nga regjistri partinë politike:

a) për mos mbajtjen e Kuvendit të partisë politike në pajtim me nenin 15.1 të kësaj rregulle.

(aa) me vendimin e KQZ-së për pezullim, partia politike obligohet që në afat të shtuar prej 45 ditë të mbaj Kuvendin e saj.

b) nuk e ka informuar Zyrën në pajtim me nenin 15.5 për mbajtjen e kuvendit të saj;

(bb) me vendimin e KQZ-së për pezullim, obligohet partia politike që në afat të shtuar prej 5 ditëve ta njoftojë Zyrën për kuvendin e mbajtur;

c) nuk i dorëzon raportet e përditësuara dhe të kompletuara vjetore në pajtim me nenin 11 të kësaj rregulle dhe raportin financiar vjetor deri më 31 mars të vitit vijues, në pajtim me Ligjin për financimin e subjekteve politike;

(cc) me vendimin e KQZ-së për pezullim, partia politike obligohet që në afat të shtuar prej 20 ditëve nga dita e pezullimit, të kryej detyrimet e saj sipas nenit 11 dhe detyrimet sipas Ligjit për financimin e subjekteve politike;

d) nuk e miraton statutin dhe programin në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle;

(dd) me vendimin e KQZ-së për pezullim, partia politike obligohet që në afat të shtuar prej 60 ditëve nga dita e pezullimit, të harmonizojë statutin dhe programin e partisë;

e) shkel nenin 18.2 18.3 të kësaj rregulle dhe nenin 7.3 të Rregullës nr. 14/2013 mbi financimin e subjekteve politike dhe sanksionet;

ee) me vendimin e KQZ-së për pezullim, obligohet partia politike që në afat të shtuar prej 15 ditëve të veprojë në përputhje me dispozitat e nenit 18.2, 18.3 të kësaj rregulle dhe me nenin 7 të Rregullës nr. 14/2013 mbi financimin e subjekteve politike dhe sanksionet;

f) nuk i ka kthyer paguesit mjetet të cilat nuk janë të miratuara ose të njëjtat nuk i ka paguar në Buxhetin e Kosovës, siç parashihet me nenin 9.2 dhe 9.3 të Rregullës 14/2013 mbi financimin e subjekteve politike dhe sanksionet;

ff) me vendimin e KQZ-së për pezullim, obligohet partia politike që në afat të shtuar prej katërmbëdhjetë (14) ditëve nga dita e pezullimit, t'i kryej detyrimet e saj sipas nenit 9.2 dhe 9.3 të Rregullës nr. 14/20013 mbi financimin e subjekteve politike dhe sanksionet.

6.2 Zyra, menjëherë pas pezullimit të regjistrimit të partisë politike:

a) në regjistrin e partive politike shënon pezullimin e saj;

b) e informon partinë politike me shkrim për hapat e nevojshëm për ta kthyer regjistrimin e partisë në gjendje të rregullt, si dhe për të drejtën e saj për të

ushtruar ankesë kundër pezullimit nga neni 9 i kësaj rregulle.

6.3 Pezullimi i regjistrimit të partisë politike mbetet në fuqi duke pritur vendimin e ankesës nga neni 9 i kësaj rregulle.

6.4 Partia politike, regjistrimi i së cilës është pezulluar, nuk merr asnjë financim publik dhe nuk certifikohet nga KQZ-ja për të marrë pjesë në zgjedhje.

6.5 KQZ-ja e shfuqizon pezullimin e regjistrimit të partisë politike menjëherë pas plotësimit të kërkesave të Zyrës dhe të evitimit të arsyeve që kanë shërbyer si bazë për pezullim.

Neni 7
Vazhdimi i regjistrimit

Partia politike e regjistruar duhet të dorëzojë formularin për të vazhduar regjistrimin e saj jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik; shtojca (4).

Neni 8
Çregjistrimi i partive politike nga regjistri

8.1 Me vendimin e KQZ-së, Zyra e fshin nga regjistri i partive politike, nëse:

a) sanksioni penal kundër subjektit politik të regjistruar do të thotë çregjistrim i atij subjekti politik siç përcaktohet nga gjykata;

b) partia politike e regjistruar, e cila në Zyrë nuk dorëzon formularin për ta vazhduar regjistrimin e saj jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik. Në rast të dështimit për tu riregjistruar në përputhje me këtë rregull, do të konsiderohet se partia do të largohet nga regjistri i partive politike;

c) nuk është certifikuar nga KQZ-ja për të marrë pjesë në tri palëzgjedhje të njëpasnjëshme;

d) vullnetarisht është shpërndarë në pajtim me statutin e saj;

e) ka qenë e pezulluar sipas dispozitave të nenit 6 të kësaj rregulle dhe nuk ka vepruar sipas afatit të shtuar, paraprakisht të përcaktuar me vendimin e KQZ-së për pezullim;

f) i është ndaluar puna nga gjykata kompetente.

8.2 Partisë politike e cila është çregjistruar nga regjistri i partive politike në pajtim me nenin 8.1 të kësaj rregulle, i pushon statusi i personit juridik dhe konsiderohet e shpërndarë, kurse kalimi i pasurisë së saj bëhet në pajtim me statutin e partisë.

8.3 Nëse nuk ka marrëveshje të subjekteve politike, ndarja e pasurisë bëhet përmes gjykatës kompetente.

Neni 9

E drejta për ankesë

Subjekti politik ose personi fizik, mund të ushtrojë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) brenda njëzet e katër orëve (24) orëve, kundër vendimit të KQZ-së, me të cilin refuzohet kërkesa e saj për: regjistrim, bashkim, shkrirje dhe vendimit të KQZ-së për pezullim dhe çregjistrim,

Neni 10

Njoftimi për ndryshimet

10.1 Partia e regjistruar politike e njofton Zyrën brenda pesë (5) ditëve të punës nga mbajtja e kuvendit, shtojca (5), nëse ajo:

a) e ndryshon emrin e saj zyrtar, akronimin ose simbolin. Ndryshimet e tilla do të koordinohen paraprakisht me Zyrën, duke marrë parasysh kërkesat nga neni 5 (c) dhe (d) i kësaj rregulle;

b) e ndryshon statutin apo programin e saj politik;

c) e ndërron kryetarin, zyrtarin për financa të partisë ose anëtarësinë e organit të saj më të lartë ekzekutiv;

d) shpërndahet vullnetarisht;

e) e ndryshon identitetin, adresën apo numrin e telefonit të personit për kontaktim, përfaqësuesit financiarë ose përfaqësuesit e partisë në çdo komunë ku partia është aktive;

f) hap apo mbyll një degë të partisë.

10.2 Partia e regjistruar politike, së bashku me njoftimin për çdo ndryshim të paraparë në nenet 10.1 (a) deri në (d) të kësaj rregulle, dorëzon kopjen e procesverbalit të mbledhjes ose të procedurës me të cilin është miratuar nldryshimi, e cila duhet të jetë e vërtetuar nga kryetari i partisë.

10.3 Partia e regjistruar politike, së bashku me njoftimin për çdo ndryshim të statutit apo programit politik të partisë, i dorëzon Zyrës kopjen e statutit apo të programit politik të ndryshuar.

Neni 11

Të dhënat e ndryshuara vjetore

11.1 Partia e regjistruar politike i kompleton dhe ia dorëzon Zyrës të dhënat e ndryshuara vjetore deri më 31 janar të çdo viti, duke identifikuar të dhënat e ndryshuara vjetore; shtojca (6):

a) emrat dhe mbiemrat, adresat aktuale të kryetarit të partisë, të anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv, të personit për kontaktim, të përfaqësuesit financiar dhe të përfaqësuesit të partisë në çdo komunë ku partia është aktive;

b) adresat aktuale të të gjitha degëve lokale të partisë në Kosovë dhe jashtë saj;

c) çdo ndryshim të statutit apo të programit politik të partisë që është bërë gjatë vitit paraprak.

Neni 12

Bashkimet

12.1 Dy ose më shumë parti politike mund të paraqesin kërkesë për bashkim, për të formuar parti të re, duke i dorëzuar Zyrës:

a) procesverbalet e mbledhjeve apo të procedurave ku janë marrë vendimet për bashkim nga secila parti politike që merr pjesë në bashkim të nënshkruar nga secili kryetar përkatës i partisë dhe

b) informatat apo dokumentet e parapara në nenin 3.1.1, 3.1.2 dhe 3.1.8 te kësaj rregulle për partinë e re.

12.2 Kërkesa për bashkim shqyrtohet nga Zyra në mënyrë të njëjtë dhe brenda afatit të njëjtë kohor sikurse kërkesa për regjistrim të partisë politike të paraparë në nenin 3 dhe 4 të kësaj rregulle.

12.3 KQZ-ja, me rekomandimin e Zyrës, nxjerrë vendim për miratimin e kërkesës për bashkimin dhe regjistrimin e partisë së re dhe çregjistron partitë politike që kanë bërë kërkesë për bashkim.

12.4 Zyra, pas vendimit të KQZ-së:

a) regjistron partinë politike të re;
b) i heq emrat e partive të bashkuara nga regjistri i partive politike;
c) njofton partinë e re politike me shkrim për miratimin e kërkesës për bashkim, si dhe çregjistrimin e partive të bashkuara.

12.5 Bashkimi ndërmjet dy apo më shumë partive politike fuqizohet në datën kur miratohet kërkesa për bashkim dhe kur regjistrohet nga KQZ-ja. Lidhur me këtë, Zyra e njofton partinë e re menjëherë.

12.6 Pas miratimit dhe regjistrimit të bashkimit nga KQZ-ja

a) e tërë pasuria dhe borxhet e partive të bashkuara politike shndërrohen në pasuri dhe në borxhe të partisë së re politike dhe

b) të gjithë anëtarët e partive të bashkuara politike bëhen anëtarë të partisë së re politike.

12.7 KQZ-ja me rekomandimin e Zyrës e refuzon kërkesën për bashkim, kur nuk është në përputhje me kërkesat e këtij neni. Zyra e njofton parashtruesin e kërkesës me shkrim menjëherë pasi e refuzon kërkesën për bashkim. Njoftimi i tillë përfshin arsyet për refuzimin dhe parashtruesin e kërkesës e njofton për të drejtën e tij në ankesë sipas nenit 9 te kësaj rregulle.

Neni 13
Shkrirja e partisë politike në një parti tjetër politike

13.1 Një parti politike e cila dëshiron të shkrihet në një parti tjetër politike, duhet të mbajë kuvend, i cili thirret sipas procedurave të statutit të saj.

13.2 Partia politike që shkrihet në një parti tjetër politike, i dorëzon Zyrës:

a) procesverbalet e mbledhjeve apo të procedurave ku është marrë vendimi për shkrirje lidhur me kalimin në një parti tjetër, duke përfshirë edhe listën e delegatëve.

13.3 Partia politike e cila e pranon partinë e shkrirë duhet të mbajë kuvend, ku do të pranohen të gjitha obligimet dhe detyrimet e partisë së shkrirë në të.

a) procesverbalin e kuvendit të partisë politike si dhe listën e delegatëve e cila pranon partinë e shkrirë në të, me të gjitha të drejtat dhe obligimet;

b) formularin për ndryshime.

13.4 KQZ-ja me rekomandimin e ZRPP-së, nxjerrë vendim për miratimin e kërkesës së partisë politike për shkrirjen e saj dhe çregjistrimin e saj nga regjistri, si dhe bartjen e detyrimeve dhe obligimeve të subjektit të shkrirë.

13.5 KQZ-ja me rekomandimin e Zyrës, e refuzon kërkesën për shkrirje kur nuk është në përputhje me kërkesat e këtij neni. Zyra e njofton parashtruesin e kërkesës me shkrim menjëherë pasi e refuzon kërkesën për shkrirje. Njoftimi i tillë përfshin arsyet për refuzimin dhe parashtruesin e kërkesës e njofton për të drejtën e tij në ankesë sipas nenit 9 të kësaj rregulle.

Neni 14
Statuti i partisë

14.1 Çdo parti e regjistruar politike ka statutin me të cilin rregullohen veprimet e partisë si tërësi, duke përfshirë edhe degët e saj.

14.2 Statuti i partisë së regjistruar politike përfshin:

a) procedurat përmes të cilave qytetarët mund të bëhen anëtarë dhe të pushojnë të jenë anëtarë të partisë, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve;

b) procedurat që duhet zbatuar për ndryshimin e statutit ose programit politik të partisë;

c) procedurat që duhet zbatuar nga partia për hyrjen në koalicion elektoral .

d) procedurat që duhet zbatuar për zgjedhjen e kryetarit, të anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv ose të zyrtarëve të tjerë të zgjedhur të partisë;

e) procedurat që duhet zbatuar për caktimin e kandidatëve të partisë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe të kuvendeve komunale;

f) mundësia e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar;

g) të drejtat e anëtarëve për tu informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjektit politik si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare;

h) krijimin e një organi për zgjidhjen e kontesteve brenda partisë lidhur me interpretimin e statutit;

i) kalimin e gjithë pasurisë së mbetur pas shlyerjes së të gjitha borxheve me rastin e shpërndarjes së partisë dhe

j) kohëzgjatjen dhe rregulloren e punës që duhet zbatuar në kuvendet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të anëtarëve të partisë, duke përfshirë edhe sigurimin e kuorumit, rendit të ditës dhe të vendimmarrjes;

k) procedurat e shpërndarjes, bashkimit apo shkrirjes së partisë politike;

l) çfarëdo dispozite tjetër që kërkohet nga ligjet tjera.

14.3 Ndryshimi në statutin e partisë së regjistruar politike që nuk përputhet me kërkesat e kësaj rregulle, është i pavlefshëm.

14.4 Çdo parti e regjistruar politike dhe të gjithë anëtarët e saj, organet ekzekutive dhe zyrtarët e saj, duhet t'i përmbahen statutit të partisë dhe kur statuti nuk është në përputhje me këtë rregull, ata u përmbahen kushteve të kësaj rregulle.

14.5 Statuti i partisë së regjistruar politike është dokument publik dhe me kërkesë të qytetarëve partia bën kopje të statutit të saj aktual. Partia mund të caktojë taksën e cila nuk tejkalon vlerën prej njëzet e pesë euro centëve (0,25 euro centë) për një faqe të kopjes së statutit.

Neni 15
Kuvendi

15.1 Partia e regjistruar politike mban kuvendin brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj së paku dyzetetetë (48) muaj.

15.2 Kryetari i partisë së regjistruar politike raporton mbi gjendjen financiare të partisë dhe paraqet raport financiar midis dy kuvendeve.

15.3 Kuvendi i partisë së regjistruar politike zgjedh kryetarin, organin më të lartë ekzekutiv të partisë në mënyrë demokratike dhe transparente brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj së paku çdo dyzet e tetë (48) muaj.

15.4 Secili anëtar i partisë së regjistruar politike, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes delegatit të caktuar sipas procedurës përkatëse ka votë të barabartë në të gjitha vendimet e marra nga kuvendi, duke përfshirë zgjedhjen e kryetarit dhe të organit më të lartë ekzekutiv të partisë.

15.5 Partia politike e regjistruar është e obliguar që ta njoftojë Zyrën në afat prej 5 ditë pune nga dita e mbajtjes se Kuvendit te saj, duke paraqitur kopjet e procesverbalit

nga kuvendi i cili duhet të vërtetohet nga kryetari i partisë.

15.6 Partia e regjistruar politike duhet ta ftojë "Zyrën" për ta vëzhguar kuvendin. Partia politike e regjistruar e njofton Zyrën për të vëzhguar kuvendin e degës së saj përkatëse. Zyra mund ta autorizojë ZLKZ-në për vëzhgimin e kuvendit te degës.

Neni 16
Zgjedhja e kandidatëve elektoralë

16.1 Partia e regjistruar politike siguron pjesëmarrje demokratike të anëtarëve të partisë në zgjedhjen e kandidatëve elektoralë të partisë.

16.2 Kandidatët e partisë së regjistruar politike në zgjedhjet për kuvendin komunal, zgjedhen nga dega apo degët e partisë në atë komunë, në përputhje me statutin e partisë.

Neni 17
Anëtarët e partisë politike

17.1 Personi duhet të ketë të drejtë vote në Kosovë për të qenë anëtar i partisë politike.

17.2 Partia e regjistruar politike mban dhe kujdeset për regjistrin e anëtarëve i cili përfshin emrat, adresat dhe regjistrimin civil, numrat e pasaportës apo të patentë shoferit të të gjithë anëtarëve të saj, si dhe datat e anëtarësimit të tyre.

17.3 Partia e regjistruar politike mund të caktojë pagesën ose taksën për anëtarët e saj e cila nuk kalon shumën prej dymbëdhjetë (12) eurosh për anëtar brenda një viti kalendarik.

17.4 Anëtarët e partisë së regjistruar politike, duke përfshirë zyrtarët e saj, nuk janë përgjegjës për borxhet e partisë.

Neni 18
Zyrtarët e partive politike

18.1 Kryetari dhe të gjithë zyrtarët tjerë të partisë së regjistruar politike duhet të jenë anëtarë të partisë.

18.2 Personi i cili është duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë apo i cili është i akuzuar nga gjykata dhe nuk i është përgjigjur urdhrit për paraqitje në gjykatë nuk mund të mbajë asnjë post apo funksion në kuadër të partisë politike apo ta përfaqësojë atë.

18.3 Avokati e Popullit dhe zëvendësin e tyre ose ndonjë person tjetër nga grupi i personave të përmendur në nenin 29 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës nuk mund të emërohen, të zgjedhen apo të mbajnë ndonjë funksion tjetër të partisë politike apo të përfaqësojnë atë.

18.4 Organi më i lartë ekzekutiv i partisë së regjistruar politike autorizon një apo më shumë persona të cilët janë të autorizuar të bëjnë marrëveshje në emër të partisë.

Neni 19

Qasja në dokumentet e partive politike

19.1 Zyra azhuron dhe mirëmban dokumentet e partive politike:

a) regjistrin e partive politike;
b) statutin e secilës parti të regjistruar politike;
c) programit politik;
d) versionet përfundimtare të të gjitha raporteve financiare vjetore të dorëzuara në Zyrë së bashku me deklaratën e auditimit të subjekteve politike;
e) regjistrin e donatorëve sipas Ligjit për financimin e subjekteve politike.

19. 2 Qasja në dokumentacionin e regjistrimit të partive politike bëhet konform rregullave të Ligjit mbi qasjen e dokumenteve zyrtare.

Neni 20

Gjobat

20.1 KQZ-ja sanksionon partitë e regjistruara politike për shkelje të kësaj rregulle bazuar në dispozitat e Ligjit 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme, Ligjit 03/L-072 për zgjedhjet lokale dhe Ligjit 03/L-174 për financimin e subjekteve politike.

20.2 Shqiptimi i gjobës nuk ndikon në pezullimin e regjistrimit të partisë politike sipas nenit 6 të kësaj rregulle.

20.3 Shqiptimi i gjobës nuk paragjykon asnjë sanksion penal që mund të zbatohet. Rastet të cilat mund të nënkuptojnë vepër penale do të përcillen nga KQZ-ja në Zyrën e Prokurorit të Kosovës.

20.4 Gjobat e mbledhura Zyra i kthen në Buxhetin e Kosovës.

20.5 Zyra mund të parashtrojë ankesë në PZAP në rastet kur partia politike nuk i paguan

gjobat në pajtueshmëri me nenin 20.1 të kësaj rregulle me afatin e përcaktuar.

Neni 21

Zgjatja e periudhës së dorëzimit të dokumenteve

21.1 Zyra mund të lejojë zgjatjen e periudhës së dorëzimit të dokumenteve të parapara në nenin 11 të kësaj rregulle dhe nenit 3.3 (b) të Rregullës nr. 14/2013 Mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, pas dorëzimit të kërkesës me shkrim të partisë së regjistruar politike për një zgjatje të tillë. Kërkesa dorëzohet me se largu pese (5) ditë para përfundimit të afatit të paraparë për dorëzimin e dokumenteve dhe përmban sqarimin për atë se partia nuk ka mundur të përmbushë afatin për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të saj. Nëse kërkesa është e arsyeshme Zyra e njofton me shkrim partinë për vendimin e saj nëse ka lejuar zgjatjen e periudhës së dorëzimit të dokumenteve brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kërkesës. Afati shtese i lejuar maksimal është dhjete (10) dite.

21.2 Pas dorëzimit të kërkesës me shkrim të partisë së regjistruar politike për një zgjatje të tillë. Kërkesa dorëzohet më së largu pesë (5) ditë para përfundimit të afatit të paraparë për dorëzimin e dokumenteve dhe përmban sqarimin për atë se partia nuk ka mundur të përmbushë afatin për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të saj. Nëse kërkesa është e arsyeshme Zyra e njofton me shkrim partinë për vendimin e saj nëse ka lejuar zgjatjen e periudhës së dorëzimit të dokumenteve brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kërkesës. Afati shtese i lejuar maksimal është dhjetë (10) ditë.

Neni 22

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

22.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulle, shfuqizohet Rregulla nr. 01/2008 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, e datës 25.06.2009; Rregulla nr. 01/2008 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës nr. 01/2008 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, e datës 11/11/2010; Rregulla nr. 01/2008 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës nr. 01/2008 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike e datës 28/03/2011.

22.2 Pjese përbërëse e kësaj rregulle janë edhe shtojcat:

Shtojca - I Formulari i Regjistrimit të Partisë Politike
Shtojca - II Formulari i konventës së fundit të partisë
Shtojca - III Lista e përkrahësve të Partisë Politike
Shtojca - IV Formulari për vazhdimin e regjistrimit të Partisë Politike
Shtojca - V Formulari i azhurnimeve vjetore të Partisë Politike
Shtojca - VI Formulari për njoftimin e ndryshimeve të Partisë Politike

Neni 23

Hyrja në fuqi

23.1 Kjo rregull hyn në fuqi me datë 02.07.2013.

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

KOMISIONI QENDRORI ZGJEDHJEVE
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

FORMULARI I REGJISTRIMIT TË PARTISË POLITIKE - FAQE 1

1. Emri zyrtar i partisë politike

1a. Akronimi

1c. Numri i telefonit

1b. Adresa

2. Emri dhe mbiemri i kryetarit

2a. Adresa

2b. Numri i telefonit

2c. E-majli

2d. Komuna

3. Emri dhe mbiemri i personit kontaktues

3a. Adresa

3b. Numri i telefonit

3c. E-majli

3d. Komuna

4. Emri i personit kontakutes për çështje financiare

4a. Adresa

4b. Numri i telefonit

4c. E-majli

4d. Komuna

Marrëveshja për t'iu përmbajtur Rregullës së KQZ-së nr. 01/2013.

Me këtë deklaroj se partia politike me emrin e cekur më lart dhe zyrtarët e saj do t'i respektojnë dhe do t'u përmbahen të gjitha dispozitave të Rregulles së KQZ-së nr. 01/2013.
Konfirmoj se të gjitha vendimet e partisë politike do të merren sipas procedurave demokratike në pajtim me nenin 14 të Rregulles së KQZ-së nr. 01/2013. Po ashtu zotohem se partia politike do të bëjë publikimet financiare siç kërkohet me nenin 7 të Rregulles së KQZ-së nr. 14/2013.
Deklaroj se të gjitha informatat e dhëna në këtë formular dhe në dokumentacionin e bashkangjitur janë të vërteta dhe të sakta.

Emri dhe mbiemri i kryetarit të partisë politike | Nënshkrimi | Data

LISTA KONTROLLUESE TË PLOTËSOHET NGA ZYRA E RPP-së

- ☐ Statuti i partisë politike
- ☐ Programi i partisë politike
- ☐ Akti i themelimit
- ☐ 500 nënshkrime të përkrahjes
- ☐ Deklarata financiare
- ☐ 500 euro tarifë
- ☐ Simboli i partisë politike

Nënshkrimi i zyrtarit të RPP-së / data e pranimit

KONVENTA E FUNDIT

Emri i partisë politike:

Data e themelimit:

LUTENI TË SHKRUANI ME SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT

	1.Emri	2.Mbiemri	3.Numri Personal	4.Data e lindjes	5.Adresa	6.Adresa	7.Numri i telefonit	8.E-mail	9.Komuniteti	10.Nënshkrimi
1.										
2.										
3.										
4.										
5.										
6.										
7.										
8.										
9.										
10.										
11.										
12.										
13.										
14.										
15.										
16.										
17.										
18.										
19.										
20.										
21.										
22.										
23.										
24.										
25.										
26.										
27.										
28.										
29.										
30.										

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE

Lista e përkrahësve të partisë politike

LISTA E PËRKRAHËSVE TË PARTISË POLITIKE

EMRI I PARTISË POLITIKE: **AKRONIMI:**

Me nënshkrimin tim shpreh përkrahjen time që partia e lartpërmendur të regjistrohet
Jam i/e vetëdijshëm/e se me nënshkrimin tim nuk mund të përkrahë më shumë se një parti.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Data e lindjes	Adresa	Numri i telefonit	Numri personal	Nënshkrimi
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						
7.						
8.						
9.						
10.						
11.						
12.						
13.						
14.						
15.						
16.						
17.						
18.						
19.						
20.						

Unë, i/e nënshkruari/a më poshtë, konfirmoj se nënshkrimet më lartë janë autentike, të dhëna vullnetarisht dhe me me kuptim të plotë të qëllimit. _____

Emri, data e lindjes, adresa dhe numri i telefonit të mbledhësit të nënshkrimeve _____

Me këtë vërtetoj nënshkrimin e mbledhësit të nënshkrimeve (nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar të partisë politike, titulli dhe data) _____

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

FORMULARI PËR VAZHDIMIN E REGJISTRIMIT TË PARTISË POLITIKE

Në bazë të nenit 12.6 dhe 12.7 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republiken e Kosovës dhe nenit 7.1 dhe 8.1 (b) të Rregullës së KQZ-së nr.01/2008 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike,
Partia Politike e regjistruar duhet të aplikojë për të vazhduar regjistrimin çdo vit jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik.

Nëse Formulari nuk dorëzohet gjer më 31.03.2014 në Zyrën për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim me rekomandim të KQZ-së, Zyra do ta largojë Partinë Politike nga Regjistri i Partive të regjistruara Politike në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi

1. Emri i Partisë Politike

2. Akronimi i Partisë Politike

3. Emri dhe mbiemri i Kryetarit të Partisë Politike

4. Adresa e zyrës kryesore të Partisë Politike

V.V

Nënshkrimi i Kryetarit të Partisë Politike

Data

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

FORMULARI I AZHURNIMEVE VJETORE TË PARTISË POLITIKE - FAQE 3

LISTA E ZYRAVE TË PARTISË DHE E PËRFAQËSUESVE TË DEGËVE

LUTENI TË SHKRUANI ME SHKRONJA TË MËDHA SHTYPI

Emri i partisë politike :

PJESA A, Zyret e partisë

	1. Komuna	2 .Adresa	3. Telefoni	4. E-majli
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				
16.				

PJESA B, Përfaqësuesit e degëve

	1. Emri dhe Mbiemri	2. Numri personal	3. Adresa/Komuna	4. Telefoni	5. E-majli
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					
15.					
16.					
17.					
18.					
19.					

*** Plotësimi i të gjitha rubrikave është i detyrueshëm përveç emajlave.**

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

FORMULARI I AZHURNIMEVE VJETORE TË PARTISË POLITIKE - FAQE 1

Përfaqësuesit e partive politike

Shënime të përgjithshme:

Në bazë të Rregulles së KQZ-së 01-2013, neni 11 partia e regjistruar politike është e obliguar që të njoftojë Zyrën e Regjistirimit të Partive Politike (tash e tutje "Zyra") lidhur me të dhënat e përditësuara vjetore më 31 janar ose para 31 janarit të çdo viti duke identifikuar:

a) emrat dhe adresat aktuale të kryetarit të partisë, të anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv, të personit për kontaktim, të përfaqësuesit financiar dhe të përfaqësuesit të partisë në çdo komunë ku partia është aktive;
b) adresat aktuale të të gjitha degëve lokale të partisë në Kosovë dhe gjetiu dhe
c) çdo ndryshim të statutit apo të programit politik të partisë që është bërë gjatë vitit paraprak.

Së bashku me njoftimin për çfarëdo ndryshimi në Statutin ose Programin politik të partisë, do të duhet të shtohet një kopje e Statutit ose Programit politik të rishikuar.

1. Emri zyrtar i Partisë Politike

2. Akronimi **3. Simboli i ndryshuar** **Po** ☐ **Jo** ☐

4. Emri dhe mbiemri i kryetarit

4a. Adresa

4b. Telefoni **4c. E-majli** _____

4d. Komuna

5. Emri dhe mbiemri i personit kontaktues

5a. Adresa

5b. Telefoni **5c. E-majli** _____

5d. Komuna

6. Emri i personit kontakutes për çështje financiare

6a. Adresa

6b. Telefoni **6c. E-mail** _____

6d. Komuna

Marrëveshje për t'iu përmbajtur Rregulles së KQZ 01-2008

Me këtë deklaroj se partia politike e lartpërmendur dhe zyrtarët e saj do të respektojnë dhe do t'u përmbahen të gjitha dispozitave të Rregulles së KQZ-së 01-2013. Poashtu, deklaroj se të gjitha informatat e paraqitura në këtë formular, si dhe dokumenti/et përcjellëse është/janë të vërteta dhe të sakta.

_____ Nënshkrimi i kryetarit të partisë politike

_____ Data

TË PLOTËSOHET NGA ZYRA E RPP-së

Në rast të ndryshimeve në Statutin dhe Programit të Partisë Politike duhet të përcillen si vijon:

☐ **kopja e Statutit të rishikuar dhe të nënshkruar nga Kryetari**

☐ **kopja e Programit politik të rishikuar dhe të nënshkruar nga Kryetari**

Nënshkrimi i zyrtarit të RPP-së / data e pranimit.

_____

FORMULARI I AZHURNIMEVE VJETORE TË PARTISË POLITIKE - FAQE 2

ORGANI MË I LARTË EKZEKUTIV I PARTISË POLITIKE

Emri i partisë politike:

LUTENI TË SHKRUANI ME SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT

Organi më i lartë ekzekutiv është:

Organi më i lartë ekzekutivë si më poshtë është zgjedhur nga **më**

	1.Posti	2.Mbiemri	3.Emri	4. Numri personal	5.Data e lindjes	6.Adresa	7.Komuna	8.Telefoni	9.E-majli	10.Nënshkrimi
1.										
2.										
3.										
4.										
5.										
6.										
7.										
8.										
9.										
10.										
11.										
12.										
13.										
14.										
15.										
16.										
17.										
18.										
19.										
20.										
21.										
22.										
23.										
24.										
25.										
26.										
27.										
28.										

*** Plotësimi i të gjitha rubrikave është i detyrueshëm përveç emajlave.**

FORMULARI PËR NJOFTIMIN E NDRYSHIMEVE TË PARTISË POLITIKE - FAQE 3
Përfaqësuesit e partive politike

Ndryshimet në degët e partisë

LUTENI TË SHKRUANI ME SHKRONJA TË MËDHA SHTYPI

Emri i partisë politike :

PJESA A, Hapja e degëve

	1. Komuna	2 .Adresa	3. Nr. i telefonit	4. E-majli
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				

PJESA B, Mbyllja e degëve:

	1. Komuna	2 .Adresa	3. Nr. i telefonit
1.			
2.			
3.			

PJESA C, Përfaqësuesit e degëve

	1. Emri dhe Mbiemri	2. Nr. personal	3. Adresa/Komuna	4. Nr. i telefonit	5. E-mail
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					
15.					
16.					
17.					
18.					
19.					
20.					

Plotësimi i të gjitha rubrikave është i detyrueshëm.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

FORMULARI PËR NJOFTIMIN E NDRYSHIMEVE TË PARTISË POLITIKE - FAQE 1
Përfaqësuesit e partive politike

Shënime të përgjithshme:
Në bazë të Rregullës së KQZ - së 01/2013 Partia e regjistruar politike e njofton Zyrën brenda pesë (5) ditëve nëse ajo:
(a) e ndryshon emrin e saj zyrtar, akronimin ose simbolin. Ndryshimet e tilla do të koordinohen paraprakisht me Zyrën, duke marrë parasysh kërkesat nga neni 5 (c) dhe (d);
(b) e ndryshon statutin apo programin e saj politik;
(c) e ndërron kryetarin, zyrtarin për financa të partisë ose anëtarësinë e organit të saj më të lartë ekzekutiv;
(d) shpërndahet vullnetarisht;
(e) e ndryshon identitetin, adresën apo numrin e telefonit të personit për kontaktim, përfaqësuesit financiar ose përfaqësuesit të partisë në çdo komunë ku partia është aktive;
(f) hap apo mbyll një degë të partisë;

1. Emri zyrtar i Partisë Politike

2. Akronimi **3. Simboli i ndryshuar** **Po** ☐ **Jo** ☐

4. Emri dhe mbiemri i Kryetarit

4a. Adresa

4b. Telefoni **4c. E-majli**

4d. Komuna

5. Emri dhe mbiemri i personit kontaktues

5a. Adresa

5b. Telefoni **5c. E-majli**

5d. Komuna

6. Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit financiar

6a. Adresa

6b. Telefoni **6c. E-majli**

6d. Komuna

Marrëveshje për t'iu përmbajtur Rregullës së KQZ - së nr. 01/2013

Me këtë deklaroj se partia politike e lartpërmendur dhe zyrtarët e saj do të respektojnë dhe do t'u përmbahen të gjitha dispozitave të Rregullës së KQZ - së nr. 01/2013.
Duke iu referuar nenit 10.1 të Rregullës, konfirmoj se të gjitha ndryshimet janë bërë jo më parë se 5 ditë para ditës kur bëhet njoftimi i Zyrës.
E kam lexuar tekstin e mësipërm dhe pajtohem me të. Poashtu, deklaroj se të gjitha informatat e paraqitura në këtë formular, si dhe dokumenti/et përcjellëse është/janë të vërteta dhe të sakta.

Nënshkrimi i kryetarit të partisë politike — Data

TË PLOTËSOHET NGA ZYRA E RPP-së

Në rast se është bërë një apo më shumë ndryshime siç është përmendur në shënimet e përgjithshme prej (a) deri në (f), duhet të përcillen si vijon:

- ☐ me kopjen e procesverbalit të mbledhjes ose punimeve në të cilën janë miratuar ndryshimet;
- ☐ kopja të jetë e vërtetuar si e saktë nga kryetari i partisë politike;
- ☐ kopja e Statutit ose Programit politik të rishikuar (nëse aplikohet)
- ☐ të bashkangjitet simboli (nëse aplikohet)

Nënshkrimi i zyrtarit të RPP-së/data e pranimit.

FORMULARI PËR NJOFTIMIN E NDRYSHIMEVE TË PARTISË POLITIKE - FAQE 2

Përfaqësuesit e partive politike

ORGANI MË I LARTË EKZEKUTIV I PARTISË POLITIKE

Emri i partisë politike:

Organi më i lartë ekzekutiv është:

Organi më i lartë ekzekutivë si më poshtë është zgjedhur nga _____ **më** _____

LUTENI TË SHKRUANI ME SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT

	1.Pozita	2.Mbiemri	3.Emri	4. Nr. personal	5.Data e lindjes	6.Adresa	7.Komuna	8.Telefoni	9.E-majli	10.Nënshkrimi
1.										
2.										
3.										
4.										
5.										
6.										
7.										
8.										
9.										
10.										
11.										
12.										
13.										
14.										
15.										
16.										
17.										
18.										
19.										
20.										
21.										
22.										
23.										
24.										
25.										
26.										
27.										
28.										

Plotësimi i të gjitha rubrikave është i detyrueshëm.